

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Atentati me snajper në burgun e Vaqarrit/ U shpall i pafajshëm në vitin 2022, Gjykata e Lartë kthen për ri gjykim dosjen e Ergys Kolaverit - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/atentati-me-snajper-ne-burgun-e-vaqarrit-u-shpall-i-pafajshe-m-ne-vitin-2022-gjykata-e-larte-kthen-per-rigjykim-dosjen-e-ergys-kolaverit
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 16:03:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 16:01:42 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	04b029d6225dd76503612b5f88ee2fec8b1ca563cc90eae923e865316f0fde7f
TEKSTI	84b06ea5d790219e86ee5b775714b3e718acf66330fbff4c1e1efc583d48c359
PAMJA	8fea7617f1514da58337249cf7306ffe212b002ac26beea015ebee702455bc63

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	14e10fe1379e87905815b65a68a58f1ef22c3dec1542fff1b2d13b301e48ce1e
E MËPARSHMJA	df470976a4482f961dbff470de67863878c23e7583cd092b1a80a6d8050ab5e4
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/14e10fe1379e87905815b65a68a58f1ef22c3dec1542fff1b2d13b301e48ce1e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Flash

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Vizita në SHBA, Rama me diasporën në Michigan: S'jemi më vend mbijetese, por shprese! Objektivi ynë, BE në 2030! Kryeministri merr dedikimin e veçantë

Kronikë

Atentati me snajper në burgun e Vaqarrit/ U shpall i pafajshëm në vitin 2022, Gjykata e Lartë kthen për rigjykim dosjen e Ergys Kolaverit

Ergys Kolaveri ishte i akuzuar për atentatin ndaj Gazmir Daçit, i cili në vitin 2015 i kishte ekzekutuar vëllain Valmir Kolaveri dhe i la të plagosur vëllain tjetër Rolandin, fqinj me njëri-tjetrin në Kamzë.



Në foto Ergys kolaveri, me bluzë të bardhë



Redaksia

15 Shtator, 17:57 | Përditësimi: 15 Shtator, 18:01

Share Tweet



Gjykata e Lartë ka kthyer për rigjykim dosjen ndaj Ergys Kolaverit, i cili u shpall i pafajshëm në tetor të vitit 2022, pas 'odisesë' gati 6-vjeçare të Kolaverit në dyert e gjykatave.

Kolaveri ka qenë i dyshuar për atentatin me snajper të mbetur në tentativë në vitin 2016 ndaj hasmit të tij, [Gazmir Daçi](#).

Pra me vendimin e sotëm, Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit të Tiranës që e shpalli Kolaverin të pafajshëm dhe e ktheu çështjen për rigjykim në të njëjtën gjykatë, me tjetër trupë gjykuese.



LEXO EDHE:

"Erdhi gjyshi dhe e goditi me thikë" nipi 14-vjeçar tregon minutat e fundit të Lumturie Patushit para se të vritej nga bashkëshorti në Tiranë

[Ergys Kolaveri](#) ishte i akuzuar për atentatin ndaj Gazmir Daçit, i cili në vitin 2015 i kishte ekzekutuar vëllain Valmir Kolaveri dhe i la të plagosur vëllain tjetër Rolandin, fqinj me njëri-tjetrin në Kamzë. Më 30 korrik të 2016-ës, Daçi i është bërë një [atentat](#) teksa ai ndodhej në burgun e Vaqarrit, kur sapo ka dalë për ajrosje. Atentati është bërë nga një kodër jashtë burgut dhe është qëlluar me snajper. Por plumbi nuk ka kapur Daçin, por një të dënuar nga Kosova.

Më 8 nëntor 2017, Ergys Kolaveri është dënuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda në atë kohë, me 20



vite burg, nga 30 që kërkoi prokuroria për atentatin e dështuar me snajper. Vendimi u apelua si nga prokuroria ashtu edhe nga Ergys Kolaveri që kërkoi pafajësi, dhe më 26 mars të vitit 2018, [gjykata e Apelit](#) për Krime të Rënda në Tiranë vendosi "konstatimin e moskompetencës lëndore të Gjykatës për Krime të Rënda, dhe prishjen e vendimit të Shkallës së parë". Po ashtu, Apeli vendosi dërgimin e çështjes kundër Kolaverit, në Gjykatën e Tiranës.

Kundër këtij vendimi bëri rekurs në Gjykatën e Lartë, prokurori i Krimeve të Rënda, i cili ka kërkuar prishjen e vendimit të Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Krimeve të Rënda. Kolegji penal i Gjykatës së Lartë pranoi kërkesën. Më pas Apeli i GJKKO në datë 23 dhjetor 2019 vendosi që nuk ka kompetencë. Çështja më në fund u kthye edhe një herë në gjykatën e juridiksionit të përgjithshëm. Më 16 janar 2020, Apeli i Tiranës vendosi lënien në arrest shtëpie të Kolaverit, pas 3 vitesh e gjysmë në burg.

Ndërsa në tetor 2022 Apeli i Gjykatës së Tiranës, e përbërë nga trupi gjykses me relatore Elona Toro dhe anëtarë Valdete Hoxha dhe Lutfije Celami, përfundimisht vendosi deklarimin e pafajshëm të Ergys Kolaverit dhe lirin e menjëhershëm të tij.

R.Xh/Shqiptarja.com

TAG: [vrasje](#) [gjykata e apelit tirane](#) [Gazmir Daci](#) [gjykata e apelit](#) [atentat](#) [ergys kolaveri](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull?  4.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

 Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës:
Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

16 Shtator, 14:18

[Të drejtë](#) [Të gabuar](#) [Nuk e di](#)

Lajme të tjera



Itali/ Pronari kap hajdutët në shtëpi dhe hap zjarr, humb jetën 25 vjeçari, dyshohet se është shqiptar

20 Shtator, 12:43



Ekzekutohet 'Tani i Rruzhdiut' në Sarandë, autorët me motor e skafandra e qëlluan sapa doli nga kafja, i përfshirë në plagosje në 2025-ën! Plumbi kap edhe një kalimtar

20 Shtator, 09:59



Alket Rizai ende në arrati, emri i tij del në një tjetër vrasje në burg në Greqi! U filmua nga kamerat e sigurisë

19 Shtator, 08:28



Report Tv siguron foton e të riut nga Lezha që u ekzekutua në Itali, trupi i pajetë u gjet brenda një automjeti të hedhur në lumë

18 Shtator, 20:10



Pjesë e grupit të trafikimit të kokainës nga Kolumbia, shqiptari i arrestuar në Greqi është Lulzim Caka! Në vendin tonë kërkohet për vrasje

12 Shtator, 20:55



I riu shqiptar u ekzekutua me një plumb në kokë në Itali, 200 kamera po analizohen për të zbuluar autorët! Pistë e re e hakmarrja, hetohet lidhja me një atentat

10 Shtator, 12:41



Atentat shqiptarit në derën e shtëpisë në Greqi, mbetet i plagosur! Vajza e gjen të mbuluar në gjak (EMRI + VIDEO)

7 Shtator, 07:36




Vrau italianen dhe plagosi 5 të rinj në Zvicër, arrestohet 43-vjeçari

1 Shtator, 08:10

Angli, shqiptari i dënuar me 19 vite burg për vrasje humb betejën e bllokimit të ekstradimit

4 Shtator, 11:57



E rëndë në Malin e Zi, rusi vret 3 persona në poligonin e qitjes dhe arratiset me makinë! Mister motivet

31 Gusht, 22:50

Itali/ Rrëmbeu ish të dashurën dhe e futi në bagazh! 47-vjeçarja telefonoi policinë për ndihmë, por kur ai pa policët e shtyu nga ura dhe u hodh pas saj

3 Shtator, 23:17



E dërgoi bashkëshortin të blinte ushqim, më pas mbyti tre fëmijët: Historia tronditëse e Lindsay Clancy dhe dilema që po ndan SHBA-në

29 Gusht, 17:01

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.